para saj që ndërli dhej me një konkurs pune për pozitën “Edukatore” në një shkollë në Komunën e Gjilanit, me ç’rast njëra nga kandidatet në këtë konkurs kishte paraqitur ankesë në Drejtorinë Komunale për Arsim në Gjilan, duke pretenduar parregullsi në këtë konkurs. Pas refuzimit të ankesës nga Drejtoria Komunale për Arsim, kandidatja kishte ushtruar, në mënyrë paralele, mjetet juridike dhe atë: (i) ankesë para Inspektoratit të Punës, me ç’rast Inspektorati kishte urdhëruar anulimin e konkursit në fjalë; si dhe (ii) padi në Gjykatën Themelore në Gjilan, e cila kishte refuzuar padinë dhe kishte konfirmuar vendimet e organeve të Komunës së Gjilanit. Si pasojë, ankuesja kishte ushtruar revizion në Gjykatën Supreme. Kjo e fundit pezulloi procedurën vendimmarrëse lidhur me rastin para saj, duke referuar çështjen në Gjykatën Kushtetuese, për vlerësimin e përputhshmërisë së nenit 94 të Ligjit të Punës me dispozitat e caktuara kushtetuese.

#### *Ankesa e parashtruesit të kërkesës*

Më saktësisht, Gjykata Supreme, para Gjykatës pretendoi se neni 94 i Ligjit të Punës nuk është në përputhshmëri me nenet 3 [Barazia para Ligjit], 24 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimin të Profesionit] dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës, pasi i njëjti, mes tjerash, cenon parimin e sigurisë juridike dhe të rendit juridik të Republikës së Kosovës, pasi mundëson procedura paralele lidhur me kontestet e punës para Inspektoratit të Punës dhe para gjykatave të rregullta lidhur me të njëjtën çështje, duke rezultuar kështu në vendime paralele dhe ndërhyrje të Inspektoratit të Punës në kompetenca gjyqësore, në kundërshtim me sigurinë juridike dhe rendin kushtetues të Republikës së Kosovës.

#### *Gjetjet e Gjykatës*

Bazuar në esencën e pretendimeve të ngritura, Gjykata vlerësoi fillimisht nëse në rrethanat e rastit konkret ndërhyrja e Inspektoratit të Punës në kompetenca të gjyqësorit ishte rezultat i papajtueshmërisë së normës së Ligjit të Punës me Kushtetutën apo rezultat i mënyrës

opštini Gnjilane, gde je jedan od kandidata na ovom konkursu uložio žalbu Opštinskoj direkciji za obrazovanje u Gnjilane, navodeći nepravilnosti u ovom konkursu. Nakon što je Opštinska direkcija za obrazovanje odbila žalbu, kandidat je uporedo koristio pravna sredstva, i to (i) žalbu Inspektoratu rada, u kom slučaju je Inspektorat rada naložio poništenje predmetnog konkursa, kao i (ii) tužbu Osnovnom sudu u Gnjilanu, koji je odbio tužbu i potvrdio odluke organa opštine Gnjilane. Kao rezultat toga, podnosilac žalbe je podneo reviziju Vrhovnom sudu. Poslednje navedeni je obustavio postupak odlučivanja u predmetu koji je pred njim, ustupajući predmet Ustavnom sudu radi ocene usaglašenosti člana 94. Zakona o radu sa pojeđinim ustavnim odredbama.

#### *Žalba podnosioca zahteva*

Tačnije, Vrhovni sud je pred Sudom tvrdio da član 94. Zakona o radu nije kompatibilan sa članovima 3. [Jednakost pred zakonom], 24. [Jednakost pred zakonom], 31. [Pravo na pravično i nepristrasno suđenje], 49. [Pravo na rad i obavljanje profesije] i 54. [Sudska zaštita prava] Ustava, jer isti, između ostalog, krši načeo pravne sigurnosti i pravnog poretka Republike Kosovo, jer omogućava paralelne postupke u vezi sa radnim sporovima pred Inspektoratom rada i pred redovnim sudovima u vezi sa istim pitanjem, što do vodi do paralelnih odluka i uplitanja Inspektorata rada u sudska ovlašćenja u suprotnosti sa pravnom sigurnošću i ustavnim poretkom Republike Kosovo.

#### *Zaključak*

Na osnovu suštine iznetih navoda, Sud je prvo ocenio da li je, u okolnostima konkretnog slučaja, uplitanje Inspektorata rada u ovlašćenja pravosuđa bila rezultat neusklađenosti norme Zakona o radu sa Ustavom ili rezultat načina tumačenja i primene predmetne norme od strane Inspektorata rada, ali i redovnih sudova. U ovoj perspektivi, Sud se prvo pozvao na sadržinu člana 94. Zakona o radu, kojim

së interpretimit dhe zbatimit të normës në fjalë nga Inspektorati i Punës, por edhe nga gjykatat e rregullta. Në këtë këndvështrim, Gjykata iu referua fillimisht përmbajtjes së nenit 94 të Ligjit të Punës i cili përcakton që mbikëqyrjen e zbatimit të dispozitave të Ligjit të Punës të cilat e rregullojnë marrëdhënien e punës, sigurinë dhe mbrojtjen në punë e bën Inspektorati i Punës në bazë të Ligjit për Inspektoratin e Punës dhe Ligjit për Siguri në Punë. Në këtë kontekst, Gjykata saktësoi që, bazuar në Ligjin e Punës dhe atë të Inspektoratit, është plotësisht i qartë fushëveprimi i kompetencës së Inspektoratit të Punës, i cili si trup inspektues dhe mekanizëm i pushtetit ekzekutiv, mbikëqyrë zbatimin e dispozitave të Ligjit të Punës të cilat e rregullojnë marrëdhënien e punës ndërmjet të punësuarit dhe punëdhënësit dhe mbikëqyrë zbatimin e Ligjit për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, në kuadër të fushëveprimit që përcakton Ligji për Inspektoratin: (i) zbatimin e masave ndëshkuese (gjobave) në rast të konstatimit të parregullsive nga ana e punëdhënësit; si dhe (ii) raportimin e këtyre parregullsive në ministrinë përkatëse ose tek ndonjë autoritetet tjetër kompetent. Inspektorati i Punës nuk ka asnjë kompetencë që të zgjidhë “kontestet e punës” apo ato që burojnë nga marrëdhënia e punës, mes të punësuarit dhe punëdhënësit, sepse bazuar në ligjet e aplikueshme, një kompetencë e tillë u takon qartësisht gjykatave të rregullta.

Në këtë aspekt, Gjykata ritheksoi se për dallim nga Inspektorati i Punës, Ligji i Punës e përcakton gjyqësorin si të vetmin autoritet përgjegjës në Republikën e Kosovës që i zgjidhë “kontestet e punës” nga e drejta e punës, në mes të punësuarit dhe punëdhënësit. Gjykata po ashtu analizoi përmbajtjen e nenit 78 (Mbrojtja e të drejtave për të punësuarit) të Ligjit të Punës, që përcakton procedurat ankimore brenda punëdhënësit dhe nenin 79 (Mbrojtja e të punësuarit në Gjykatë) të Ligjit të Punës, që garanton të drejtën që çdo i punësuar i cili konsideron se vendimi i punëdhënësit ka shkelur të drejtat e tij ose nuk merr përgjigje nga punëdhënësi, të iniciojë kontest pune në Gjykatën kompetente. Gjykata theksoi se, funksionet gjyqësore mund t'i ushtrojnë vetëm gjykatat, sipas parimeve të përcaktuara me

je propisano da nadzor nad sprovođenjem odredaba Zakona o radu, kojima se uređuje radni odnos, bezbednost i zaštita na radu, vrši Inspektorat rada na osnovu Zakona o Inspektoratu rada i Zakona o bezbednosti na radu. U tom kontekstu, Sud je precizirao da je na osnovu Zakona o radu i Zakona o Inspektoratu rada potpuno jasan obim nadležnosti Inspektorata rada i koji inspeksijski organ i mehanizam izvršne vlasti vrši nadzor nad sprovođenjem odredaba Zakona o radu koje uređuju radni odnos između zaposlenog i poslodavca i vrše nadzor nad sprovođenjem Zakona o bezbednosti i zdravlju na radu u delokrugu utvrđenom Zakonom o Inspektoratu, (i) sprovođenje kaznenih mera (novčanih kazni) u slučaju utvrđivanja nepravilnosti od strane poslodavca; i (ii) prijavljivanje ovih nepravilnosti nadležnom ministarstvu ili bilo kom drugom nadležnom organu. Inspektorat rada nema nadležnost da rešava „radne sporove“ ili one koji proizilaze iz radnog odnosa između zaposlenog i poslodavca, jer na osnovu zakona na snazi, ta nadležnost očigledno pripada redovnim sudovima.

U ovom aspektu, Sud je ponovio da za razliku od Inspektorata rada, Zakon o radu definiše pravosuđe kao jedini odgovorni organ u Republici Kosovo koji rešava „radne sporove“ iz radnog prava između zaposlenih i poslodavca. Sud je analizirao i sadržinu člana 78. (Zaštita prava zaposlenih) Zakona o radu, kojim su definisani žalbeni postupci kod poslodavca, i člana 79. (Zaštita zaposlenog na sudu) Zakona o radu, kojim se garantuje pravo da zaposleni koji smatra da su mu odlukom poslodavca povređena prava ili ne dobije odgovor od poslodavca, može da pokrene radni spor kod nadležnog suda. Sud je istakao da sudske funkcije mogu da vrše samo sudovi, po načelima definisanim Ustavom i relevantnim zakonima. Štaviše, jasno je da je Inspektorat rada, prema zakonu, definisan kao izvršno telo koji osniva Ministarstvo rada i socijalne zaštite, i kao takav, i u smislu EKLJP-a, odnosno člana 6. (Pravo na pravično su-

Kushtetutë dhe ligjet përkatëse. Për më tepër, është e qartë që Inspektorati i Punës sipas ligjit përcaktohet si trupë ekzekutive të cilën e themelon Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe si i tillë, edhe në kuptim të KEDNJ-së, gjegjësisht të nenit 6 (E drejta për një proces të rregullt) të saj, nuk i plotëson kushtet as të një *“tribunali të pavarur”* nga ekzekutivi dhe as të një *“gjykate”* të themeluar me ligj. Organet inspektuese, varësisht sipas natyrës së funksioneve që ushtrojnë dhe statusit institucional të përcaktuar nga aktet që kanë themeluar ato, janë pjesë e pushtetit ekzekutiv dhe si të tilla nuk mund të ushtrojnë funksione të natyrës gjyqësore. Nëse do të veprohej kështu, kjo do të përbënte shkelje të parimit të ndarjes së pushteteve në cenim të rendit kushtetues të Republikës së Kosovës. Andaj, Gjykata konsideroi se në rastin konkret pretendimi për ndërhyrje në kompetenca të gjyqësorit nga ana e Inspektoratit të Punës, nuk është rezultat i papajtueshmërisë së përmbajtjes së nenit 94 të Ligjit të Punës me normat kushtetuese, por rezultat i mënyrës së interpretimit dhe zbatimit të nenit 94 të Ligjit të Punës dhe Ligjit për Inspektoratin e Punës, nga vet Inspektorati i Punës.

#### **Përfundimi**

Për pasojë dhe bazuar edhe në sqarimet e dhëna në Aktgjykimin e publikuar, Gjykata konstatoi se neni 94 (Mbikëqyrja) i Ligjit të Punës është në përputhshmëri me nenet: 3 [Barazia para Ligjit], 24 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës, pasi dhe ndër të tjera, i njëjti nuk përcakton asnjë kompetencë që Inspektorati i Punës të zgjidhë *“kontestet e punës”* nga e drejta e punës mes të punësuarit dhe punëdhënësit, kompetencë kjo që bazuar në ligjet e aplikueshme, i takon pushtetit gjyqësor.

Është iste, ne ispunjava uslove *„nezavisnog tribunala“* od izvršne vlasti niti *„suda“* ustanovljenog zakonom. Inspekcijski organi, u zavisnosti od prirode funkcija koje obavljaju i institucionalnog statusa utvrđenog aktima kojima su ustanovljeni, deo su izvršne vlasti i kao takvi ne mogu vršiti funkcije sudske prirode. Ako bi se tako postupalo, to bi predstavljalo povredu načela podele vlasti, čime bi se povredio ustavni poredak Republike Kosovo. Stoga je Sud smatrao da u konkretnom slučaju navod za uplitanje u ovlašćenja pravosuđa od strane Inspektorata rada nije rezultat neusklađenosti sadržaja člana 94. Zakona o radu sa ustavnim normama, već rezultat tumačenja i sprovođenja člana 94. Zakona o radu i Zakona o Inspektoratu rada od strane samog Inspektorata rada.

#### **Zaključak**

Kao rezultat gore navedenog i na osnovu pojašnjenja datih u objavljenoj presudi, Sud je utvrdio da je član 94. (Nadzor) Zakona o radu u skladu sa članovima 3. [Jednakost pred zakonom], 24. [Jednakost pred zakonom], 31. [Pravo na pravično i nepristrasno suđenje], 49. [Pravo na rad i obavljanje profesije] i 54. [Sudska zaštita prava] Ustava, jer isti, između ostalog, ne definiše nikakvu nadležnost Inspektoratu rada za rešavanje *„radnih sporova“* iz prava na rad između zaposlenog i poslodavca, koja na osnovu važećih zakona pripadaju sudskoj vlasti.

Neni 12 [Pushteti Lokal]  
Neni 123 [Parimet e Përgjithshme]  
Neni 124 [Organizimi dhe Funksonimi i Vetëqeverisjes Lokale]

Član 12 [Lokalna Vlast]  
Član 123. [Osnovna Načela]  
Član 124. [Organizovanje i Funkcionisanje Lokalne Samouprave]

### *Ndërhyrje në kompetencat vetanake dhe përgjegjësitë komunale*

*KO173/21, Parashtrues: Komuna e Kamenicës, Vlerësim i kushtetutshmërisë së neneve 3, 4, 5, 6, 7 dhe 9 të Udhëzimit Administrativ të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës (MASH) nr. 104/2020 për “Kriteret dhe Procedurat e Themelimit dhe Pushimit të Veprimtarisë së Institucioneve të Arsimit Parauniversitar”*

Përderisa kompetenca për përcaktimin e kriterëve dhe kushteve të përgjithshme që një institucion edukativ-arsimor ose paralele e ndarë duhet t'i plotësojë, i është përcaktuar Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës vendimmarrja për themelimin e institucioneve të nivelit parauniversitar, i takon komunave:  
- *shkelje e kompetencave kushtetuese të komunave*

#### *Faktet*

Thelbi që ngërthejnë rrethanat e rastit konkret, ndërliiden me kompetencat që i janë përcaktuar pushtetit qendror, përkatësisht Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës në njërën anë dhe pushtetit lokal, përkatësisht komunave në anën tjetër, përkitazi me themelimin e institucioneve edukative-arsimore dhe paraleleve të ndara në komuna, përmes Udhëzimit Administrativ të lartcekur. I njëjti, ndër tjerash, saktëson se vendimi për themelimin dhe pushimin e institucioneve edukative-arsimore dhe paraleleve të ndara të nivelit parauniversitar, merret nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, bazuar në propozimin e komunës përkatëse.

#### *Ankesa e parashtruesit të kërkesës*

Vendimmarrja në nivel të pushtetit qendror, përkatësisht, Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, përkitazi me themelimin/pushimin e

### *Mešanje u sopstvene nadležnosti i odgovornosti opštine*

*KO173/21, Podnosilac: Opština Kosovska Kamenica, Ocena ustavnosti članova 3, 4, 5, 6, 7 i 9 Administrativnog uputstva Ministarstva obrazovanja i nauke (MON) br. 104/2020 o “kriterijumima i procedure osnivanja i prestanak aktivnosti institucije preduniverzitetskog obrazovanja”*

Dok je nadležnost za utvrđivanje opštih kriterijuma i uslova koje jedna edukativno-obrazovna institucija ili izdvojeno odeljenje mora da ispuni, određena Ministarstvu obrazovanja i nauke, odlučivanje o osnivanju institucija preduniverzitetskog nivoa, pripada opštinama:  
- *povreda ustavnih nadležnosti opština.*

#### *Činjenice*

Suština okolnosti konkretnog slučaja se odnosi na ovlašćenja koja su dodeljena centralnoj vlasti, odnosno Ministarstvu obrazovanja i nauke, s jedne strane, i lokalnoj vlasti, odnosno opštinama, s druge strane, u vezi sa osnivanjem edukativno-obrazovnih institucija i izdvojenih odeljenja podeljene po opštinama kroz gore navedeno Administrativno uputstvo. Isto, između ostalog, pojašnjava da odluku o osnivanju i zatvaranju edukativno-obrazovnih institucija i izdvojenih odeljenja preduniverzitetskog nivoa donosi generalni sekretar Ministarstva obrazovanja i nauke na predlog relevantne opštine.

#### *Žalba podnosioca zahteva*

Donošenje odluka na nivou centralne vlasti, odnosno Ministarstva obrazovanja i nauke, u vezi sa osnivanjem/zatvaranjem edukativno-obrazovnih institucija i



institucioneve edukative-arsimore dhe paraleleve të ndara në nivel parauniversitar, sipas parashtruesit të kërkesës, cenon përgjegjësitë komunale, në kundërshtim me dispozitat përkatëse kushtetuese dhe ato të ligjeve të aplikueshme, përkatësisht të Ligjit nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar, Ligjit nr. 03/L-68 për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës dhe Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, sipas të cilit, *“ofrimi i arsimit publik parashkollor, fillor dhe të mesëm, duke përfshirë regjistrimin dhe licencimin e institucioneve edukative, punësimin, pagesën e rrogave dhe trajnimin e instruktorëve dhe administratorëve të arsimit”*, përbën kompetencë vetanake të komunave dhe si e tillë, është kompetencë e *“plotë dhe ekskluzive”* në nivel komunal.

#### *Gjetjet e Gjykatës*

Fillimisht dhe sa i përket pranueshmërisë së kërkesës, Gjykata sqaroi se pas parashtrimit të kërkesës për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Udhëzimit Administrativ të kontestuar nga, atëkohë, Kryetari i Komunës së Kamenicës, z. Qëndron Kastrati, më 17 tetor 2021, respektivisht 14 nëntor 2021, pas zhvillimit të raundit të dytë të zgjedhjeve lokale në Republikën e Kosovës, Kryetar i ri i Komunës së Kamenicës u zgjodh, z. Kadri Rahimaj. Ky i fundit, përmes përfaqësuesit të tij, më 5 janar 2022, parashtrori në Gjykatë kërkesën për tërheqje të lëndës KO173/21, me arsyetimin se nuk ka interes juridik për shqyrtimin e saj. Gjykata, bazuar në praktikën e saj gjyqësore dhe rregullin 35 (Tërheqja, hedhja poshtë dhe refuzimi i kërkesës) të Rregullores së punës, sipas të cilit, pavarësisht kërkesës për tërheqje Gjykata mund të përcaktojë të vendosë përkritazi me kërkesën fillestare, fillimisht vlerësoi kërkesën e Kryetarit të ri të Komunës dhe vendosi të refuzojë të njëjtën, duke pasur parasysh interesin publik për vazhdimin e shqyrtimit dhe vendosjes meritore në rast, me theks në rëndësinë e qartësisht të pretendimeve për shkëlqje të parimeve kushtetuese lidhur me vetëqeverisjen lokale.

Ndërsa, sa i përket meritave të rastit, në adresimin e pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, Gjykata fillimisht shtjelloi parimet e

izdvojenih odeljenja preduniverzitetskog nivoa, prema podnosiocu zahteva, krši opštinske nadležnosti u suprotnosti sa relevantnim ustavnim odredbama i odredbama zakona na snazi, odnosno Zakona br. 04/L-032 o preduniverzitetskom obrazovanju, Zakona br. 03/L-68 o obrazovanju u opštinama Republike Kosovo i Zakona br. 03/L-040 o lokalnoj samoupravi, prema kome *„pružanje predškolskog, osnovnog i srednjeg obrazovanja, uključujući registrowanje i licenciranje obrazovnih ustanova, prijem radnika, isplata plata i obučavanje instruktora za obrazovanja i administratora“*, predstavlja sopstvenu nadležnost opština i kao takva je *„potpuna i isključiva“* na nivou opštine.

#### *Nalazi Suda*

Kao prvo i u pogledu prihvatljivosti zahteva, Sud je pojasnio da je nakon podnošenja zahteva za ocenu ustavnosti osporenog Administrativnog uputstva od strane tadašnjeg gradonačelnika opštine Kosovska Kamenica, g. Qëndrona Kastratija 17. oktobra 2021. godine, odnosno 14. novembra 2021. godine, nakon drugog kruga lokalnih izbora u Republici Kosovo, za novog gradonačelnika opštine Kosovska Kamenica je izabran g. Kadri Rahimaj. Poslednje navedeni je, preko svog punomoćnika, 5. januara 2022. godine podneo Sudu zahtev za povlačenje predmeta KO173/21, sa obrazloženjem da ne postoji pravni interes za njegovo razmatranje. Sud je, na osnovu svoje sudske prakse i pravila 35 (Povlačenje, odbijanje i odbacivanje podnesaka) Poslovnika o radu, prema kojem i pored zahteva za povlačenje Sud može da odluči o prvobitnom zahtevu, prvo ocenio zahtev novog gradonačelnika opštine i odlučio da isti odbije, vodeći računa o javnom interesu za nastavak razmatranja i meritornom odlučivanju u slučaju, sa akcentom na važnost razjašnjenja navoda o povredi ustavnih načela u vezi sa lokalnom samoupravom.

përgjithshme lidhur me vetëqeverisjen lokale sipas Kushtetutës, Kartës Evropiane për Vetëqeverisje Lokale, Opinioneve relevante të Komisionit të Venecias, ligjeve në fuqi në Republikën e Kosovës, si dhe praktikës gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese.

Gjykata, duke u bazuar në nenet 12, 123 dhe 124 të Kushtetutës, respektivisht, ndër të tjerash, ritheksoi se: (i) njësi themelore territoriale të vetëqeverisjes lokale në Republikën e Kosovës janë komunat; (ii) organizimi dhe kompetencat e njërive të vetëqeverisjes lokale rregullohen me ligj; (iii) komunat kanë kompetenca “vetanake”, “të zgjeruara” dhe “të deleguara”; dhe (iv) rishikimi administrativ i akteve të komunave nga autoritetet qendrore në fushën e kompetencave të tyre, kufizohet në

sigurimin e përputhjes me Kushtetutën dhe me ligjin. Për më tepër, bazuar në këto nene kushtetuese, Gjykata theksoi që, veprimtaria e organeve të vetëqeverisjes

lokale bazohet në Kushtetutë dhe në ligje, dhe respekton Kartën Evropiane për Vetëqeverisjen Lokale. Kjo e fundit, ndër të tjera, dhe për aq sa është e rëndësishme për rrethanat e rastit konkret, përcakton që: (i) autoritetet lokale, brenda kufijve të ligjit, do të kenë diskrecionin e plotë për të ushtruar iniciativën e tyre në lidhje me çdo çështje që nuk përjashtohet nga kompetenca e tyre dhe nuk i është caktuar në kompetencë ndonjë autoriteti tjetër; (ii) kompetencat që u besohen autoriteteve lokale normalisht duhet të jenë të plota dhe ekskluzive, dhe ato nuk mund të minohen apo të kufizohen nga një autoritet tjetër, qendror apo rajonal, përveç siç përcaktohet me ligj; dhe (iii) çdo kontroll administrativ mbi autoritetet lokale mund të ushtrohet vetëm sipas formave dhe në rastet e parashikuara nga Kushtetuta ose me ligj.

Gjykata gjithashtu ritheksoi se, vetëqeverisja lokale është e një rëndësie të tillë në rendin kushtetues, sa që Kushtetuta (i) ka përcaktuar këto garanci, ndër të tjerash, në Dispozitat Themelore të saj; (ii) ka përcaktuar respektimin e Kartës Evropiane për Vetëqeverisjen Lokale; dhe (iii) me qëllim të sigurimit të mbrojtjes së këtyre garancive, në

Sho se tiče merituma slučaja, razmatrajući navode podnosioca zahteva, Sud je prvo razradio opšta načela koja se odnose na lokalnu samoupravu prema Ustavu, Evropskoj povelji o lokalnoj samoupravi, relevantnim Mišljenjima Venecijanske komisije, zakonima na snazi u Republici Kosovo i sudskoj praksi Ustavnog suda.

Sud je, na osnovu članova 12, 123 i 124 Ustava, između ostalog, ponovio da (i) su osnovne teritorijalne jedinice lokalne samouprave u Republici Kosovo opštine; (ii) organizacija i ovlašćenja jedinica lokalne samouprave se uređuju zakonom; (iii) opštine imaju „svoja“, „proširena“ i „poverena“ ovlašćenja; i (iv) administrativno razmatranje opštinskih akata od strane centralne vlasti u oblasti njihovih ovlašćenja, je ograničeno samo na procenu saglasnosti sa Ustavom Republike Kosovo i zakonom. Štaviše, na osnovu ovih ustavnih članova, Sud je istakao da je delatnost organa lokalne samouprave zasnovana na Ustavu i zakonima i da poštuje Evropsku povelju o lokalnoj samoupravi. Poslednje navedena, između ostalog, i u meri u kojoj je relevantno za okolnosti konkretnog slučaja, utvrđuje da (i) lokalne vlasti, u granicama zakona, imaju punu diskreciju da sprovedu svoju inicijativu u vezi sa bilo kojim pitanjem koje nije isključeno iz njihove nadležnosti i nije dodeljeno nekom drugom organu u nadležnost; (ii) ovlašćenja koja su poverena lokalnim vlastima obično moraju biti potpuna i isključiva i ne mogu biti potkopana ili ograničena od strane druge vlasti, centralne ili regionalne, osim ako je to određeno zakonom; i (iii) svaka administrativna kontrola nad lokalnim vlastima može se vršiti samo prema oblicima i u slučajevima predviđenim Ustavom ili zakonom.

Sud je takođe ponovio da je lokalna samouprava od takvog značaja u ustavnom poretku da je Ustav (i) definisao ove garancije, između ostalog, u svojim Osnovnim odredbama; (ii) utvrdio usklađenost sa Evropskom poveljom o lokalnoj samou-

nenin 113 të saj, u ka dhënë komunave qasje të drejtpërdrejtë në Gjykatën Kushtetuese, në cilësi të palëve të autorizuar, që të kontestojnë kushtetutshmërinë e ligjeve ose të akteve të Qeverisë të cilat cenojnë përgjegjësitë komunale ose zvogëlojnë të hyrat e komunës, në rast se komuna përkatëse është prekur nga ai ligj ose akt.

Në përputhje me garancitë e lartcekura të Kushtetutës dhe Kartës Evropiane për Vetëqeverisjen Lokale, dhe referimin e të njëjtave në detyrimin që këto garanci të zbatohen edhe përmes ligjeve të aplikueshme, Gjykata gjithashtu rikujtoi që, bazuar në nenin 17 (Kompetencat vetanake) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale komunat kanë kompetenca “*të plota dhe ekskluzive*” në ofrimin e arsimit publik parashkollor, fillor dhe të mesëm, duke përfshirë regjistrimin dhe licencimin e institucioneve edukative, punësimin, pagesën e rrogave dhe trajnimin e instruktorëve dhe administratorëve të arsimit. Në anën tjetër, Ministria e Arsimit dhe Shkencës, bazuar në Ligjin për Arsimin Parauniversitar dhe Ligjin për Arsimin në Komuna, ndër tjerash, mban përgjegjësinë kryesore për planifikimin, caktimin e standardeve dhe sigurimin e cilësisë së sistemit të arsimit parauniversitar, dhe ka përgjegjësinë të promovojë dhe të përmirësojë cilësinë dhe efikasitetin e arsimit, aftësimin përmes inspektimit të arsimit, monitorimin dhe vlerësimin me qëllim të ngritjes së cilësisë dhe mbikëqyrjes së zbatimit të legjislacionit në fuqi.

Duke zbatuar parimet e lartcekura në rrethanat e rastit konkret, përkatësisht vlerësimin kushtetues nëse Udhëzimi Administrativ i kontestuar cenon përgjegjësitë komunale, Gjykata, ndër tjerash, theksoi se kompetenca për vendimmarrje të plotë të pushtetit qendror për themelimin dhe shuarjen e institucioneve të nivelit parauniversitar në komuna, që i është dhënë Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës përmes neneve 3, 6, 7 dhe 9 të Udhëzimit Administrativ të kontestuar, sipas sqarimeve të dhëna në Aktgjykimin e publikuar, cenon “*kompetencat vetanake*” të komunës. Kjo sepse, bazuar në mënyrën e saktësuar në dispozitat përkatëse të Ligjit për Vetëqeverisjen

pravi; i (iii) da bi osiguraao zaštitu ovih garancija, u svom članu 113, dao je opština-nama direktan pristup Ustavnom sudu, kao ovlašćenim stranama, da osporavaju ustavnost zakona ili akata Vlade, koji krše opštinske odgovornosti ili umanjuju prihode opštine, u slučaju da je relevantna opština pogođena tim zakonom ili aktom.

U skladu sa gore navedenim garancijama Ustava i Evropske povelje o lokalnoj samoupravi i upućivanjem istih u obavezu da se ove garancije sprovode i kroz važeće zakone, Sud je takođe podsetio da na osnovu člana 17. (Izvorna nadležnost) Zakona o lokalnoj samoupravi, opštine imaju „*potpuna i isključiva*“ ovlašćenja u pružanju predškolskog, osnovnog i srednjeg obrazovanja, uključujući registrovanje i licenciranje obrazovnih ustanova, prijem radnika, isplatu plata i obučavanje instruktora za obrazovanje i administratora. S druge strane, Ministarstvo obrazovanja i nauke, na osnovu Zakona o preduniverzitetskom obrazovanju i Zakona o obrazovanju u opštinama, između ostalog, snosi glavnu odgovornost za planiranje, postavljanje standarda i obezbeđivanje kvaliteta preduniverzitetskog obrazovnog sistema i ima odgovornost da promoviše i unapređuje kvalitet i efikasnost obrazovanja i obuke kroz inspekciju obrazovanja, praćenje i evaluaciju u cilju podizanja kvaliteta i nadzora nad sprovođenjem zakona na snazi.

Primjenjujući gore navedena načela na okolnosti konkretnog slučaja, odnosno na ocenu ustavnosti da li osporeno Administrativno uputstvo zadire u nadležnosti opština, Sud je, između ostalog, naglasio da nadležnost za potpuno odlučivanje centralne vlade za osnivanje i zatvaranje preduniverzitetskih institucija u opštinama, koje je dato Ministarstvu obrazovanja i nauke kroz članove 3, 6, 7 i 9 osporenog Administrativnog uputstva, prema pojašnjenjima datim u objavljenoj presudi, povređuje „*sopstvene nadležnosti*“ opštine. Ovo iz razloga što, na način preciziran u relevantnim odredbama Zakona

Lokale, Ligjin për Arsimin në Komuna dhe Ligji për Arsimin Parauniversitar, vendimmarrja për themelimin e institucioneve të nivelit parauniversitar i takon komunave. Ndërsa, sa i përket neneve 4 (Kushtet për themelimin e institucionit edukativ-arsimor ose paraleles së ndarë) dhe 5 (Propozimi për themelimin e institucionit edukativ-arsimor ose paraleles së ndarë) të Udhëzimit Administrativ të kontestuar, të cilat, ndër tjerash, përcaktojnë kompetencën e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës për të përcaktuar kushtet që duhet të plotësojnë institucionet edukative-arsimore dhe paralelet e ndara dhe dokumentacionit të nevojshëm përmes të cilit mund të vërtetohet plotësimi i të njëjtave, Gjykata vlerësoi se të njëjtat nuk cenojnë “kompetencat vetanake” komunale. Kjo sepse, në parim, kompetenca për përcaktimin e kriterëve dhe kushteve të përgjithshme që një institucion edukativ-arsimor ose paralele e ndarë duhet t'i plotësojë, përmes ligjeve të lartcekura të aplikueshme dhe siç është sqaruar në Aktgjykimin publikuar, i është përcaktuar Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës.

Gjykata përfundimisht ritheksoi se, bazuar në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, përkatësisht nenin 123 të saj, vetëqeverisja lokale është e garantuar dhe e rregulluar me ligj, dhe bazuar në nenin 124 të saj, çdo rishikim administrativ i akteve të komunave nga autoritetet qendrore në fushën e kompetencave të tyre, kufizohet në sigurimin e përputhjes me Kushtetutë dhe ligj. Në kuptim të kësaj, Gjykata theksoi se pushteti qendror, dhe në rrethanat e rastit konkret, Ministria e Arsimit dhe Shkencës, përmes akteve nënligjore nuk mund t'i përcaktojë vetes kompetenca që nuk i janë përcaktuar me ligj të miratuar nga Kuvendi i Republikës, e të cilat kompetenca mund të ndërhyjnë në veprimtarinë e vetëqeverisjes lokale në fushën e arsimit apo të cenojnë përgjegjësitë komunale në këtë fushë. Një parim i tillë, në kuptim të vetëqeverisjes lokale, buron edhe nga dispozitat e Kartës Evropiane. Gjykata vëren se, Kushtetuta dhe ligjet e aplikueshme qartësisht saktësojnë ndarjen e kompetencave përkatëse, duke përfshirë edhe në fushën e arsimit, dhe që

o lokalnoj samoupravi, Zakona o obrazovanju u opštinama i Zakona o preduniverzitetkom obrazovanju, donošenje odluka o osnivanju institucija preduniverzitetskog nivoa pripada opštinama. Što se tiče članova 4. (Uslovi za osnivanje edukativno-obrazovne institucije i izdvojena odeljenja) i 5. (Predlaganje za osnivanje edukativno-obrazovne institucije ili izdvojeno odeljenje) osporenog Administrativnog uputstva, a koji, između ostalog, utvrđuju nadležnost Ministarstva obrazovanja i nauke da utvrdi uslove koje moraju da ispunjavaju edukativno-obrazovne institucije ili izdvojena odeljenja i potrebnu dokumentaciju kojom se dokazuje ispunjenost istih, Sud je ocenio da isti ne krše „sopstvene nadležnosti“ opštine. Ovo iz razloga što je, u principu, nadležnost za utvrđivanje opštih kriterijuma i uslova koje edukativno-obrazovne institucije ili izdvojena odeljenja moraju da ispunje kroz gore navedene važeće zakone i kao što je pojašnjeno u objavljenoj presudi, poverena Ministarstvu obrazovanja i nauke.

Sud je na kraju ponovio da je na osnovu Ustava Republike Kosovo, odnosno njegovog člana 123, lokalna samouprava zagarantovana i regulisana zakonom, a na osnovu njegovog člana 124, svako administrativno razmatranje opštinskih akata od strane centralne vlasti u oblasti njihovih ovlašćenja je ograničeno samo na procenu saglasnosti sa Ustavom Republike Kosovo i zakonom. U smislu napred navedenog, Sud je naglasio da centralna vlast, a u okolnostima konkretnog slučaja, Ministarstvo obrazovanja i nauke, podzakonskim aktima, ne može za sebe da definiše ovlašćenja koja nisu definisana zakonom usvojenim od strane Skupštine Republike i koja mogu da se upliću u delatnost lokalne samouprave u oblasti obrazovanja ili da krše opštinske nadležnosti u ovoj oblasti. Takav princip u smislu lokalne samouprave proizilazi i iz odredaba Evropske povelje. Sud primećuje da je Ustavom i važećim zakonima jasno preci-



të dy nivelet e qeverisjes janë të detyruara të veprojnë në përputhje të plotë me të njëjtat.

#### *Përfundimi*

Si përfundim, në vlerësimin e kushtetutshmërisë së Udhëzimit Administrativ të kontestuar, Gjykata, njëzëri, vendosi që: (i) kërkesa është e pranueshme; dhe (ii) neni 3 (Themeluesi), paragrafët 5, 6 dhe 7 të nenit 6 (Verifikimi i kushteve), paragrafët 2 dhe 3 të nenit 7 (Vendimi) dhe paragrafët 6, 7 e 8 të nenit 9 (Pushimi i veprimtarisë së institucionit edukativ-arsimor ose paraleles së ndarë) të Udhëzimit Administrativ të kontestuar, nuk janë në përputhshmëri me paragrafin 2 të nenit 12 [Pushteti Lokal], paragrafët 1 dhe 3 të nenit 123 [Parimet e Përgjithshme] dhe me paragrafët 2 dhe 3 të nenit 124 [Organizimi dhe Funksionimi i Vetëqeverisjes Lokale] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe si të tilla shfuqizohen.

zirana podela relevantnih ovlašćenja, uključujući i u oblasti obrazovanja, te da su oba nivoa vlasti dužna da postupaju u potpunosti u skladu sa istim.

#### *Zaključak*

Kao zaključak, ocenjujući ustavnost osporenog Administrativnog uputstva, Sud je jednoglasno odlučio da je (i) zahtev prihvatljiv; i (ii) da član 3. (Osnivač), stavovi 5, 6 i 7 člana 6. (Provera uslova), stavovi 2 i 3 člana 7. (Odluka) i stavovi 6, 7 i 8 člana 9. (Prestanak aktivnosti edukativno-obrazovne institucije ili izdvojenog odeljenja) osporenog Administrativnog uputstva, nisu u skladu sa stavom 2 člana 12. [Lokalna vlast], stavovima 1 i 3 člana 123. [Osnovna načela] i stavovima 2 i 3 člana 124. [Organizovanje i funkcionisanje lokalne samouprave] Ustava Republike Kosovo, i kao takvi se stavljaju van snage.